

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Video - SYRI TV/ Moody's paralajmëron për pronat në Shqipëri, çmimet e banesave rrezikojnë stabiliteti n financiar
ADRESA	https://www.syri.net/ekonomi/917996/syri-tv-moodys-paralajmeron-per-pronat-ne-shqiperi-c-mimet-e-banesave-rrezikojne-stabilitetin-financiar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 14:00:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 13:26:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f32d49031bf5786e8a93170241ad375aebde2b1ef7e8354de6e00017c283d7df
TEKSTI	d14138df73c3f44ef07a0460c1a60e44035b3e3d4d014d80a79f9ffbc7f412bc
PAMJA	566b4ce64324a9df5a19c42b28abc503a2b62031701eedf25f1c54b85ba6f580

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4389cddd3603859b6abe6a34cd0ad455e085156c0dfb84e91c8157af9ef8d2b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9767af9aea99dbf2ca0400fc3d10892444ae0e1100c3c88a0d864d11255bea91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.



Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4389cddd3603859b6abe6a34cd0ad455e085156c0dfb84e91c8157af9ef8d2b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës**më të lexuarat**Pse bankat evropiane po e heqin arin e
tyre nga SHBA-ja?Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga
janari, Edi Rama dyfishon çmimetBordi cakton çmimet e e reja: Nafta do
shitet me 219 lekë dhe benzina me 195
lekëShpopullimi masiv/ Ikin të rinjtë,
dyfishohet numri i pensionistëve të
punësuarBB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e
nevojshëm për ujë e kanalizime, por nuk
ka ujëThellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/
Fasoni në rënie të pandalshme, zbrit në
grupin e dytë**SYRI TV/ Moody's paralajmëron për
pronat në Shqipëri, çmimet e banesave
rrezikojnë stabilitetin financiar**

15:26, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Rritja e shpejtë e çmimeve të banesave dhe ekspozimi i bankave ndaj tregut të pasurive të paluajtshme po shndërrohen në një nga dobësitë që mund të cenojnë stabilitetin financiar në Shqipëri. Paralajmërimi vjen nga agjencia ndërkombëtare e vlerësimit Moody's, e cila e lidh rrezikun me mundësinë e një korrigjimi të fortë të tregut. Sipas të dhënave të cituara në raport, kreditë e lidhura me pasuritë e paluajtshme përbënin rreth 20% të aktiveve të sistemit bankar në tremujorin e tretë të vitit 2025.

Rritja e shpejtë e çmimeve të banesave dhe ekspozimi i sektorit bankar ndaj tregut të pasurive të paluajtshme po shndërrohen në një nga rreziqet që mund ta ekspozojnë ekonominë shqiptare ndaj goditjeve të papritura. Paralajmërimi vjen nga agjencia ndërkombëtare e vlerësimit Moody's, e cila evidenton tregun e pasurive të paluajtshme mes dobësive që mund të cenojnë stabilitetin financiar në rast të një korrigjimi të fortë. Kjo agjenci e lidh rrezikun jo vetëm me çmimet e pronave, por me ndërthurjen e tyre me sektorin financiar. Rëndësia e këtij rreziku bëhet më e qartë edhe te skenarët që Moody's përcakton për ecurinë e mëtejshme të vlerësimit të Shqipërisë.

"Faktorët që mund të çojnë në uljen e vlerësimit ose në rikthimin e perspektivës në të qëndrueshme janë: Perspektiva mund të rikthehet në të qëndrueshme nëse rritja ekonomike ngadalësohet ndjeshëm, deficitet fiskale zgjerohen në mënyrë të konsiderueshme, ose nëse rriten dobësitë e sektorit financiar, veçanërisht ato që burojnë nga tregu i pasurive të paluajtshme apo nga goditje të jashtme të papritura", thuhet në raport.

Sipas Monitor, vlerësimi është veçanërisht i rëndësishëm në kushtet kur tregu shqiptar i pasurive të paluajtshme ka kaluar një cikël të gjatë rritjeje të çmimeve, i shoqëruar edhe me zgjerimin e kreditimit për blerjen e banesave. Rritja e ekspozimit të bankave ndaj tregut të pronave është bërë gjithnjë e më e dukshme. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ka evidentuar më herët të njëjtën dobësi. Sipas FMN-së, që nga viti 2019 aktiviteti i ndërtimit dhe çmimet e pasurive të paluajtshme janë rritur ndjeshëm, ndërsa ekspozimi i bankave ndaj sektorit është zgjeruar.

Në tremujorin e tretë 2025, kreditë e lidhura me pasuritë e paluajtshme përbënin

rreth 20% të aktiveve totale të sistemit bankar. Paralajmërimi për pasuritë e paluajtshme vjen në të njëjtin raport ku Moody's dha një sinjal pozitiv për profilin e përgjithshëm të vendit, teksa pritet që borxhi publik të ulet nga 52.9% e PBB-së në fund të 2025 në 50.2% në 2027, ndërsa deficit i llogarisë korrente, që ra në minimumin historik prej 0.7% të PBB-së në 2025, pritet të mbetet pranë 1% në vitet 2026–2027. Agjencia parashikon gjithashtu rritje ekonomike prej 3.6% në 2026 dhe 3.5% në 2027, por në të njëjtën kohë evidenton se nevojat relativisht të larta për huamarrje dhe rreziqet që lidhen me rritjen e shpejtë të çmimeve të banesave mbeten pika dobësie për ekonominë shqiptare.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë



Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera



Bordi cakton çmimet e e reja: Nafta do shitet me 219 lekë dhe benzina me 195 lekë

Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

'Taksë e fshehtë' mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë

TË NGJASHME



BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por nuk ka ujë



Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga janari, Edi Rama dyfishon çmimet



Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?



Këmbimi valutor sot - Ja me sa blihen e shiten dollari dhe euro, si luhaten monedhat e tjera



Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin



'Taksë e fshehtë' mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria



Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbrit në grupin e dytë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net